

## PUNA DITËN E DIEL

### Parimi.

Punonjësi nuk mund të punojë më shumë se gjashtë ditë në javë sepse ai zotëron 24 orë pushimi në javë, i quajtur ndryshe pushimi javor. Pushimi javor është caktuar në parim të dielën (artikulli L.3132-1 deri në L.3132-3 i Kodit të Punës). Këtij pushimi javor i shtohen 11 orët e detyrueshme të pushimit të përditshëm. Si rrjedhojë, punonjësi përfiton një pushim javor prej 35 orësh të njëpasnjëshme.

Nëse ju jeni në kërkim të një pune, i regjistruar në Polin e punës, ju keni mundësinë të refuzoni të firmosni një kontratë pune që përfshin punën gjatë ditës së diel, duke vazhduar të ruani emrin tuaj në listën e personave në kërkim të një pune (article L. 3132-3-1 du Code du travail).

### Përrjashtimet e pushimit javor.

Një punonjës mund të sillet në punë të dielën sipas aktiviteteve ose ndërmarrjeve të caktuara. Atëherë, detyrimi për të caktuar një ditë pushimi javore të dielën mund zhvendoset në rastet e mëposhtme :

#### 1. Përrjashtimet e përrhershme pa nevojë autorizimi

- Punëdhënësi mund të reduktojë prej një gjysmë dite pushimin javor të personelit të mirëmbajtjes në institucionet industriale ose tregtare (psh : Opera e Parisit, RATP, SNCF, ndërmarrjet industriale ose tregtare private...) nëse :
  - Punët e pastrimit realizohen domosdoshmërisht ditën e pushimit kolektiv;
  - Pushimi javor është caktuar të njëjtën ditë për të gjithë punonjësit.
- Punëdhënësi mund të akordojë pushimin javor të përrsëritshëm<sup>1</sup> në institucionet, funksionimi ose hapja e të cilave është kthyer prej domosdoshmërisë nga detyrimet e prodhimit, aktivitetit ose nevojave të publikut. Shembuj të institucioneve të ndikuara: industrinë agrike dhe ushqimore, industrinë du lëkurës, të tekstilit dhe të veshjes, ndërmarrjet e gazetave dhe të informacionit, institucionet e tregtisë së detajeve (mobilimi, ndërtimi), debitë e duhanit, postet e shpërndarjes së karburantit dhe lubrifikantëve për automjete, transport dhe ndërtim (artikujt L.3132-12 dhe R.3132-5 të Kodit të Punës).
- Pranë tregjeve të detajeve ushqimore, pushimi javor mund të jepet të shtunën duke filluar nga ora 13. Punonjësit përfitojnë nga një pushim kompensues<sup>2</sup> të një dite të plotë të përrsëritshme dhe dyjavorësh. Shembuj të tregjeve të detajeve ushqimore: minimarketet, supermarketet, dyqanet multi tregtare, hipermarketet, ushqim i përrgjithshëm... Supermarketet dhe hipermarketet me sipërfaqe mbi 4000 m<sup>2</sup> duhet tu caktojnë punnjësve që punojnë të dielën një ritje të rrogës prej të paktën 30%. (artikulli L.3132-13 I Kodit të Punës).
- Rojet dhe portirët të institucioneve industriale dhe komerciale përfitojnë nga një pushim kompensues nëse pushimi nuk mund të jepet ditën e diel. (artikulli L.3132-11 I Kodit të Punës)

#### 2. Përrjashtimet që kërkjnë autorizim ose informimin e inspeksionit të punës

- Pranë institucioneve ku punëdhënësi cakton që pushimi i njëkohshëm, ditën e diel, për të gjithë personelin e institucionit do të ishte i dëmshëm për publikun ose do të rezikonte funksionimin normal të institucionit, prefekti autorizon që pushimi t'i jepet punnjësve ose një ditë tjetër përveç të dielës, ose nga e diela në mesditë deri të hënë në mesditë, ose të dielën pasdite me një ditë pushimi kompensuese të përrsëritshme ose dyjavorësh, ose me përrsëritje të gjithëve ose një pjese të punnjësve (artikulli L.3132-20 i Kodit të Punës) ;

<sup>1</sup> Nëse pushimi jepet me përrsëritje, ai caktohet një ditë çfarëdo të javës, rrjedhimisht nga mesdita në mesditën e ditës së nesërme

<sup>2</sup> Pushimi kompensues është një kohë pushimi e caktuar për të kompensuar punën e të dielës

- Në industri të caktuara që funksionojnë vetëm gjatë një pjese të vitit (industri sezoni), pushimet javore mund të shtohen nën kushtin që çdo punëtor të përfitojë prej 2 ditësh pushimi në muaj, brenda mundësive të dielën (artikulli L.3132-7). Inspektori i punës est avisé përpara nisjes së punës.  
Shembuj të aktiviteteve të sezonit të parashikuara nga Kodi i Punës : punë në ndërtesa, hotele, restorante, furnizues ushqimesh, rotiseri, konservatet e frutave, perimeve dhe peshkut, fabrikat e tullave, litarëve, institucionet bregdetare (articles R. 3132-3 et R. 3132-4 du Code du travail) ;
- Pranë industrive që trajtojnë lëndë degraduese ose që kanë një rritje të jashtëzakonshme të aktivitetit, pushimi javor mund të pezullohet dy herë në muaj, por duhet që numri i suspensioneve në vit të mos i kalojë 6. Orët e punës së përmbushur të dielën konsiderohen si orë suplementare. Inspektori i punës duhet këshilluar përpara nisjes së punës (artikulli L.3132-5 i Kodit të Punës).  
Shembuj aktivitetesh referuar kodit: furrat e bukës, pasticeritë, mobileritë, tapiceritë, stolitë për mobiljet, bizhuteritë, lavanteritë, fabrika kartonësh për lodrat, dyqanet e çokollatave, kartëvizitave, shiritave, parfumeritë. sipas artikullit R. 3132-1 të Kodit të Punës.
- Pushimi javor mund të pezullohet për personelin e nevojshëm në ekzekutimin e punëve të caktuara urgjente (matje shpëtimi, parandalimi i aksidenteve imminente ose riparimi i aksidenteve materiale, i instalimeve ose i ndërtesave të institucionit, artikujt L.3132-4 dhe R.3132-7 të Kodit të Punës).

### **3. Përrjashtime të vendosura nga një marrëveshje kolektive, një marrëveshje e ndërmarrjes ose një autorizim i inspektimit të punës**

- Pushimi javor mund të caktohet një ditë tjetër dhe jo të dielën në ndërmarrjet, industriale nëse punonjësi është pjesë e një ekipi të zëvendësimi. Një ekip zëvendësimi vendoset kur personeli funksionon në dy grupe. Ekipi i zëvendësimit ka për funksion vetëm të zëvendësojë ekipin tjetër gjatë ditës ose ditëve të pushimit të caktuara për grupin e parë.
- Industritë ku një konvencion ose një marrëveshje kolektive<sup>3</sup>, ose akoma një marrëveshje e ndërmarrjes parashikon mundësinë e organizimit të punës në mënyrë të vazhdueshme për arsye ekonomike mund ta japin pushimin javor me përsëritje (artikulli L.3132-14 i Kodit të Punës).
- Në institucionet e zonave turistike dhe zonave komerciale, pushimi javor mund të jepet me përsëritje për të gjithë ose një pjesë të personelit (artikujt L.3132-25 dhe L.3132-25-1 i Kodit të Punës).

Vendosja në praktikë e punës së të dielës në këto zona supozon ekuivalenca për punonjësit e përfshirë të caktuar nga marrëveshja kolektive. Për më tepër, vetëm punonjësit vullnetar mund të caktohen të punojnë të dielën.

## **PUNA E NATËS**

### **Përkufizimi i punës së natës.**

Puna e natës nuk duhet të ngatërrohet me punën në mbrëmje. Periudha e punës së natës fillon minimumi në orën 21 dhe përfundon maksimumi në orën 7 të mëngjesit (artikulli L.3122-2 al.2 I Kodit të Punës).

Si rrjedhojë, konsidërohet punë e natës puna e kryer në një periudhë prej 9 orësh të njëpasnjëshme në intervalin midis mesnatës dhe orës 5 (artikulli L.3122-2 al.1 I Kodit të Punës).

Një punëtor quhet punëtor nate:

<sup>3</sup> marrëveshja kolektive është një marrëveshje midis nga njëra anë një punonjësi ose një grupi punonjësish dhe, nga ana tjetër, një ose disa organizatash sindikale që përfaqësojnë punonjësit për të trajtuar një ose disa tema specifike relative me kushtet e punës (pagat, formimi profesional, plotësuesit e shëndetit, kohëzgjatja e punës...). Marrëveshja kolektive ndryshon nga konvencioni kolektiv i cili vendos tërësinë e kushteve të punës të punonjësve si dhe garancitë e tyre sociale. Konvencioni kolektiv ka një fushë aplikimesh nacionale dhe aplikohet në të gjitha ndërmarrjet të një sektori profesional, të ashtuquajtura degë të aktivitetit. Marrëveshja kolektive, ose marrëveshja e ndërmarrjes, aplikohet në ndërmarrjet ku ajo është vendosur.

- Nëse ai përmbush, të paktën dy herë në javë, sipas orarit të tij të punës së zakonshëm, të paktën 3 orë të kohës së punës së tij gjatë orarit të punës së natës;
- Nëse ai përmbush, gjatë një periudhe reference, një numër minimal orësh pune nate në sensin legal (artikulli L.3122-5 I Kodit të Punës).

Rekursi në punën e natës duhet të jetë një përjashtim sepse puna e natës nuk është mënyra normale e organizimit të punës, dhe duhet të justifikohet nga domosdoshmëria për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik ose serviset e përdorimit shpërqëror. Punëdhënësi duhet të marrë parasysh rregullat e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurimit të punëtorëve. (artikulli L.3122-1 I Kodit të Punës).

Në zonat turistike ndërkombëtare<sup>4</sup> (ZTI), institucionet e shitjes së dejave që vënë në shërbim të mira dhe servise mund të rrinë hapur për publikun deri në mesnatë. Fillimi i periudhës së natës mund të shtyhet deri në mesnatë (në vend të orës 21), kështu puna e kryer midis orës 21 dhe mesnatës hyn në kadrin e punës së mbrëmjes. Periudha e punës së natës, nëse fillon pas orës 22, është të paktën 7 orë të njëpasnjëshme ku përfshihet intervali midis mesnatës dhe orës 7 (artikulli L.3122-4 I Kodit të Punës).

Për aktivitete të caktuara (psh: aktivitete të prodhimit redaktues dhe industria e shtypit, e radios, televizionit, të prodhimit dhe përdorimit kinematografik...) periudha e punës së natës është të paktën 7 orë të njëpasnjëshme duke përfshirë intervalin midis mesnatës dhe orës 5 së mëngjesit (artikulli L.3122-3 I Kodit të Punës).

Periudha e punës së natës si dhe numri minimal i orëve që përcaktojnë kualifikimin e punëtorit të natës në një periudhë reference mund të caktohen nga një marrëveshje e ndërmarrjes ose institucionit ose, në mungesë të tyre, një konvencion ose një marrëveshje kolektive e degëve. Në mungesë të marrëveshjes kolektive, numri minimal i orëve që përcaktojnë kualifikimin e punëtorit të natës është 270 orë në një periudhë prej 12 muajsh të njëpasnjëshme (artikulli L.3122-22 I Kodit të Punës).

Inspektori i punës mundet gjithashtu të autorizojë një përkufizim të punës së natës ndryshe nga periudha legale e caktuar nga Kodi i Punës nëse karakteristikat e aktivitetit të ndërmarrjes e justifikojnë këtë veprim (artikulli L.3122-22 I Kodit të Punës).

### **Kohëzgjatja ditore dhe javore maksimale e punës së natës.**

Kohëzgjatja ditore e punës së përmbushur nga një punëtor nate nuk mund të kalojë 8 ore (artikulli L.3122-6 I Kodit të Punës). Kohëzgjatja javore e punës së punëtorit të natës, e llogaritur në një periudhë prej 12 javësh së njëpasnjëshme, nuk mund të kalojë 40 orë. (artikulli L.3122-7 I Kodit të Punës)

Autorizime të tejkallimit të kohëzgjatjes ditore të punës së natës mund të parashikohen nga një marrëveshje kolektive (artikulli L.3122-17 I Kodit të Punës) ose nga autorizimi i inspektorit të punës në raste të veçanta pas konsultimit me përfaqësuesit e personelit (L.3122-6 I Kodit të Punës). Ligji parashikon mundësinë përjashtimit nga kohëzgjatja javore maksimale të punës së natës prej 40 nëse kjo e fundit nuk ka një efekt që ta rrisë këtë kohëzgjatje në mbi 44 orë për 12 javë të njëpasnjëshme (artikulli L.3122-18 I Kodit të Punës).

### **Ekuivalencat e punës së natës.**

Punëtorët e natës përfitojnë ekuivalenca në formën e pushimit kompensues ose, përndryshe, të kompensimit në formë page (artikulli L.3122 i Kodit të Punës). Në rastin e tejkallimit të kohëzgjatjes ditore të punës së natës, punëdhënësi duhet të marrë parasysh ekuivalencat e pushimit në përfitim të punonjësve. Periudhat e pushimit duhet të jenë të paktën ekuivalente me numrin e orëve të kryera përtej kohëzgjatjes maksimale ditore të punës. Pushimi duhet të caktohet nga punëdhënësi në kadrin e periudhës së punës (artikulli R.3122-3 i Kodit të Punës).

- Kalimi nga një orar dite në orar nate përbën një ndryshim në kontratën e punës, që duhet të pranohet nga punëtori (artikulli L.3122-12 i Kodit të Punës).
- Në rast detyrimesh familiare imperiuases, kryesisht përkujdesja ndaj një fëmije ose ndaj një personi të varur, punëtori mund të refuzojë të pranojë ndryshimin, nëse kjo e fundit nuk përbën një gabim ose një motiv pushimi nga puna.

<sup>4</sup>Shembuj të ZTI : Paris (krijimi i dymbëdhjetë ZTI) : Maillot / Ternes, Champs-Élysées / Montaigne, Montmartre, Haussmann, Saint-Honoré / Vendôme, Les Halles, Le Marais / République, Olympiades, Cour Saint-Émilion / Bibliothèque, Rennes Saint-Sulpice, Saint-Germain, Beaugrenelle ; Antibes, Dijon, Nice...

- Punëtori i natës duhet të përfitojë nga nja ndjekje individuale e rregullt e gjendjes së tij shëndetsore (artikulli L.3122-11 i Kodit të Punës) dhe nëse gjendja e tij e shëndetit, e konstatuar nga mjeku i punës, e kërkon, punëtori mund të jetë objekt i një transferimi të përkohshëm ose definitiv në një post dite (artikulli L.3122-14 i Kodit të Punës).
- Puna e natës e të rinjve nën 18 vjeç është në parim e ndaluar (artikulli L.3163-2 i Kodit të Punës) por përjashtime në raste të veçanta mund të akordohen nga inspektori i punës.

## PUNA E DITËVE PUSHIM

---

**Lista e ditëve pushim.** Kodi i punës parashikon në listë prej 11 ditësh festash ligjore (artikulli L.3133-1 i Kodit të Punës):

- 1 Janari ;
- E hëna e Pashkëve ;
- 1 Maji ;
- 8 Maji ;
- Festa e Ngjitjes ;
- E hëna e Pentecote ;
- 14 Korriku ;
- 15 Gushti ;
- 1 Nëntori ;
- 11 Nëntori ;
- 25 Dhjetori ;

Përveç 1 Majit, një marrëveshje ndërmarrjeje ose institucioni ose në mungesë së tyre, një marrëveshje degësh, mund të caktojë ditët pushim (artikulli L.3133-3 -1 i Kodit të Punës). Në mungesë të marrëveshjes kolektive, punëdhënsi përcakton këtë listë (artikulli L.3133-3-2 i Kodit të Punës).

**Pagesa e ditëve pushim.** 1 Maji është e vetmja ditë pushim dhe që paguhet e parashikuar nga Kodi i Punës (artikulli L.3133-6 i Kodit të Punës). Nëse në ditën e 1 Majit punohet, punonjësi merr dyfishin e pagës së tij të zakonshme (artikulli L.3133-6 i Kodit të Punës).

Përsa i përket ditëve të tjera pushim, punonjësit mujorë dhe sezonalë paguhen për ditët pushim vetëm nëse kanë të paktën 3 muaj në ndërmarrje ose institucion (artikulli L.3133-3 i Kodit të Punës). Kjo nuk është e vlefshme për ata që punojnë nga shtëpia, punonjësit që punojnë jo në intervale të rregullta dhe për punonjësit e përkohshëm.

Punonjësi që punon gjatë një dite pushim merr një pagë normale, përveç në prezencën e një rregulli më të favorshëm të konvencionit kolektiv ose të një përdorimi më me avantazh.

Punonjësit me kontratë për një kohë të përcaktuar (CDD) përfitojnë nga pagesa e ditëve pushim nga momenti që punonjësit e tjerë të ndërmarrjes përfitojnë.

Orët e punës në një ditë pushim nuk mund të kompensohen. Punëdhënësi pra nuk mund ti kërkojë punonjësit që ky l fundit të kryejë këto orë një ditë tjetër të javës.